

Nr. 1583 Prot.

Tiranë, më 19/03/2024

Lënda: Mbi çmimin e energjisë elektrike për kategorinë e klientëve furrë buke dhe prodhim mielli

Drejtuar: Znj. Eriola SADUSHI ✓
Kryetar në Detyrë
Enti Rregullator i Energjisë

Për dijëni: Z. Enea KARAKAÇI
Administrator
Oshee Group SH.A.

Z. Gëzim PESHKOPIA

Kryetar

Shoqata e Prodhuesve të Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave

Të nderuar,

Furnizuesi i Shërbimit Universal furnizon klientët fundorë në bazë të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Kushteve të përgjithshme të kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” si dhe Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë. Klientët fundorë të furnizuar nga FSHU SH.A. faturohen me çmime të rregulluara nga Enti Rregullator i Energjisë, për secilën kategori.

Një nga kategoritë e furnizuara me çmim të rregulluar është kategoria “Furrë buke dhe prodhim mielli” në nivelin e tensionit 0.4 kV, ku çmimi i miratuar është 7.6 lekë/kWh.

Nga verifikimet e kryera në terren, aktiviteti i sipërpërmendur, ushtrohet në të njëjtin ambjent me aktivitete të tjera si pastiçeri, shitje nënprodukte brumi, kafe, market etj, duke e vendosur FSHU SH.A. përpara vështirësisë në tarifimin e saktë të subjekteve “Furrë buke dhe prodhim mielli” dhe të aktiviteteve të tjera që nuk përfitojnë nga kjo tarifë.

Shoqata e Prodhuesve të Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave në korrespondenca të mëparshme ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me aplikimin e dy kontratave për të njëjtin ambjent, ku njëra faturohet si Furrë Buke/prodhim mielli me çmimin 7.6 lekë/kWh dhe tjetra me çmim kategorie privat 14 lekë/kWh.

Kjo praktikë ka rezultuar me kosto të lartë dhe lë vend për abuzime me energjinë elektrike.

Nisur dhe nga sa më sipër si dhe masave të marra me rishikimin e procedurave të aktivitetit të furrave të bukës dhe ose prodhim mielli, FSHU SH.A. nga kontrollet e ushtruara në një pjesë të konsiderueshme të subjekteve ka konstatuar që abuzohet padrejtësisht nga tarifa 7.6 lekë/kWh e aktivitetit Furrë buke/Prodhim mielli.

Shoqata e Prodhuesve të Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për të evituar abuzimet e mundshme të krijuara nga zgjidhjet e dhëna, duke kërkuar kategorizimin e aktiviteteve për përfitimin e çmimeve për aktivitetin e Furrave të Bukës.

Kategoritë e propozuara janë si më poshtë:

I. Kategoria e I, ku përfshihen subjektet të cilat përfitojnë cmimin 7.6 lekë/kWh të energjisë elektrike.

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Liçenca për Prodhim dhe tregëtim buke me Nipt të veçantë të dedikuar ose Sekondar.
2. Ambienti i prodhimit ose tregëtimit të jetë i veçantë, me dalje më vete dhe i ndarë me ambientet e tjera.
3. Duhet të jenë këto pajisje të domosdoshme:
 - Dhome Ardhje, Brumatrice me kapacitet mbi 50kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregëtimin e Bukës.

II Kategoria e II, ku përfshihen subjektet të cilat përfitojnë çmimin 9.5 lekë/kWh të energjisë elektrike.

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Liçenca duhet të jetë: Prodhim dhe Tregëtim Buke, Brumëra dhe Pastiçerie.
2. Në Ambientet e prodhimit dhe tregëtimit duhet të jenë këto pajisje të domosdoshme:
 - Dhomë Ardhje, Brumatrice me kapacitet mbi 50kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregëtimin e Bukës.
3. Në ambient mund të ketë si dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregëtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave.
 - Pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie, banaqe (ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregëtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave.

III Kategoria e III, subjektet të cilat përfitojnë çmimin 12 lekë/kWh të energjisë elektrike

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Këtë çmim do ta përfitojnë të gjitha ato subjekte që në ambientet e tyre, prodhohet dhe tregëtohet, bukë, pastiçeri dhe prodhime brumërash,
 2. Duhet të ketë të instaluar pajisjet përkatëse.
- Dhome Ardhje, Brumatriçe me kapacitet mbi 50kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregëtimin e Bukës.
 - 3. Në ambient mund të ketë si dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregëtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave.
 - Pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie, banaqe(ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregëtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave.
4. Në këto ambiente mund të përfshihet edhe shërbimi:
- Bar- Kafe dhe Ushqim Vetë-shërbim.

Referuar të dhënave të sistemit të faturimit dhe përlllogaritjeve të kryera, rezulton se për vitin 2023 kategoria: Furrë Buke dhe Prodhim mielli ka një konsum prej rreth 67,800,000 Kwh dhe impakti financiar për këtë kategori është 515.280.000 Lekë.

Në zbatim të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar “Metodologjisë së përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, si dhe me qëllim aplikimin e drejtë dhe jo diskriminues të çmimeve të energjisë elektrike ndaj klientëve dhe për përfitimin e drejtë të çmimit të energjisë elektrike për aktivitete të caktuara, kërkohet nga ana juaj:

- Përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për aktivitetin “Furrë Buke, prodhim mielli në nivelin e tensionit 0.4 kV në kategori:

- **Kategoria I**

Vetëm Furra Buke/Prodhim mielli – Çmimi i furnizimit me energji elektrike 7.6 lekë/kWh;

- **Kategoria II**

Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri – Çmimi i furnizimit me energji elektrike 9.5 lek/kWh;

- **Kategoria III**

Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri, shërbim Kafe (ekspres) – Çmimi i furnizimit me energji elektrike 12 lek/kWh.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

Algert LUZI
Administratör

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.

